



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI TEKNIK

NR. 13147/11 PROT

Tiranë, më 09.07.2026

UDHËZIM

Nr. 4 Prot., date 09.07.2026

PËR

**DISA SHITESA E NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 07, DATË 27.03.2019 “ MBI
ZBATIMIN PRAKTIK TË REGJIMIT TË MAGAZINIMIT DOGANOR”**

Në zbatim të neneve 27, 28, 30 deri 32, 191 deri 199 dhe 210 deri 215, të ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; neneve 14 deri 19, 21, 22, 31, 32, 539, 545, 631 deri 633 të Vendimit Nr.651 , datë 10.11 2017 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar mbi procedurat doganore lidhur me regjimin e magazinimit doganor;

Bazuar në nenin 737, të Vendimit Nr.651 , datë 10.11 2017 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar;

UDHËZOJ:

Në Udhëzimin Nr. 07 datë 27.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të regjimit të magazinimit doganor” bëhen ndryshimet si më poshtë:

Në pikën 3 të paragrafit II “Aplikimi për të përfituar Autorizim për funksionim të ambjenteve për Magazinim Doganor”;

në nënpikën “f” shtohet: Administratori i magazinës duhet të vendosë në dispozicion të autoriteteve doganore të dhënat për aksesin e kamerave në mjediset e brendshme të ruajtjes së mallrave.

shtohet nënpika “g” me këtë përmbajtje;

g) Për qëllime të ruajtjes dhe sigurisë së mallrave administratori i magazinës duhet të paraqesë një informacion të detajuar dhe të dokumentuar mbi masat për kushtet e ruajtjes dhe sigurisë së mallrave ku përfshihet ruajtja/siguria fizike e ambjenteve dhe sistemet e mbrojtjes kundër zjarrit

Pika 3 e paragrafit IV. “Shqyrtimi dhe miratimi” ndryshon me përmbajtje si më poshtë;

Pas aprovimit të autorizimit dhe paraqitjes së garancisë (që garanton 100% të detyrimeve doganore të mallrave që magazinohen e cila duhet të jetë në përputhje me nenët 84 deri 94, të Ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar”), autorizimi bëhet i vlefshëm në sistemin Asycuda World.

Pika 1 e paragrafit VI. “Detyrimet e administruesit të regjimit të magazinimit doganor”, ndryshon me përmbajtje si më poshtë;

1. Personat që administrojnë një regjim të magazinimit doganor duhet të mbajnë regjistrimet e duhura në një formë të miratuar nga autoritetet doganore. Regjistrimet mund të mbahen në format letre ose në formatin elektronik.

- a. Plotësimi i regjistrit të magazinimit doganor në format letre realizohet sipas modelit të aneksit 5 dhe 5/1 të cilin duhet ta sekretojë në degën doganore mbikqyrëse. Mosplotësimi i këtij regjistri apo plotësimi me mangësi konsiderohet shkelje dhe trajtohet sipas penalteteve të parashikuara nga Kodi Doganor. Në rastet kur është autorizuar edhe depozitimi i mallrave shqiptare në të njëjtat ambiente detyrimisht duhet të jetë plotësuar libri i inventarit sipas aneksit nr.6.
- b. Regjistri elektronik i magazinimit doganor duhet të pasqyrojë të gjitha të dhënat e parashikuara në nenin 557 të Vendimit Nr.651 , datë 10.11 2017 të Këshillit të Ministrave “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor” i ndryshuar. Ky regjistër duhet të jetë i mbrojtur, i sigurtë dhe të ketë të paktën një “back up” sipas standartit për ruajtjen e të dhënave. Regjistri duhet të jetë i tillë që të identifikojë mallrat sipas statusit doganor të tyre, si dhe të jetë i çertifikuar nga një shoqëri e licencuar për sistemet IT nga institucionet shtetërore Shqiptare.

Në çdo rast gjëndja fizike duhet të përputhet me gjëndjen sipas regjistrave.

Në pikën 1 të paragrafit VIII. “Formalitetet e vendosjes së mallrave nën regjimin e magazinës doganore”, hiqet nga përdorimi procedura;

--72 Regjimi i magazinimit doganor për mallra shqiptare.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja

Besmir Beja

